Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 10 maj 2012

Lënda nr. 36/08

Jahja MORINA

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 10 maj 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Z. Paul LEMMENS
Znj. Christine CHINKIN

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, Zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve, paraqet konstatimet dhe rekomandimet vijuese:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u paraqit nga ankuesi më 11 gusht 2008 dhe u regjistrua më 20 gusht 2008. Ankuesi vdiq më 19 nëntor 2008. Më 10 dhjetor 2008, zotërinjtë Menditon Morina dhe Besnik Morina, bijtë e ankuesit, e informuan Panelin për qëllimin e tyre që të ndjekin tutje ankesën e paraqitur. Për arsye praktike, Paneli do të vazhdojë që z. Jahja Morinën ta quaj ankuesin, edhe pse kjo zotësi tani duhet atribuuar zotërinjve Menditon Morina dhe Besnik Morina. Në procedurën pranë Panelit, ankuesi dhe trashëgimtarët e tij u përfaqësuan nga z. Zeqirja Morina.

2. Ankuesi siguri informacione shtesë më 6 tetor 2008.

3. Më 22 tetor 2008, Paneli ia komunikoi ankesën Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë dhe bazueshmërinë e lëndës. Më 28 nëntor 2008, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e tij të parë.

4. Më 15 dhjetor 2008, Paneli ia rikomunikoi lëndën PSSP-së, pa marrjes së informacioneve shtesë nga ankuesi.

5. Më 19 janar 2009, PSSP-ja i dha komentet e dyta të UNMIK-ut për pranueshmërinë e ankesës.

6. Më 23 prill 2009, Paneli kërkoi që UNMIK-u të sqaronte disa elemente në përgjigjen e tij. Më 2 korrik 2009, PSSP-ja ofroi komente shtesë mbi lëndën.

7. Më 9 shtator 2009, Paneli ua dërgoi komentet e PSSP-së trashëgimtarëve të ankuesit.

8. Trashëgimtarët e ankuesit e dhanë përgjigjen e tyre për komentet e PSSP-së në një shkresë të datës 25 shtator 2009. Më 22 tetor 2009, ata i dorëzuan Panelit informacione shtesë.

9. Më 8 dhjetor 2009 dhe 26 shkurt 2010, Paneli ia dërgoi PSSP-së përgjigjen e trashëgimtarëve të ankuesit dhe informacionet shtesë për informimin e tyre.

10. Më 16 dhjetor 2010, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

11. Më 20 dhjetor 2010, Paneli e informoi PSSP-në për vendimin dhe kërkoi komentet e UNMIK-ut për bazueshmërinë e lëndës. Më 18 janar 2011, PSSP-ja e dha përgjigjen e UNMIK-ut.

12. Më 13 prill 2011, Paneli ua dërgoi trashëgimtarëve të ankuesit komentet e PSSP-së dhe i ftoi ata të paraqesin komente shtesë po të dëshironin. Më 22 prill 2011, Paneli i pranoi komentet e tyre.

II. FAKTET

13. Ankuesi, tani i ndjerë, ishte pronar i kompanisë private “Sh.P.T. Top Gun”, që ndodhej në Gjilan. Punën në këtë kompani ai e filloi më 2 maj 2001. UNMIK-u i lëshoi certifikatë për regjistrimin e përkohshëm të biznesit më 12 gusht 2001.

14. Me qëllim të regjistrimit të përkohshëm të biznesit, ankuesi deklaroi se aktivitetet ekonomike të biznesit të tij do të ishin “tregtia me pakicë e produkteve në dyqane speciale”, “ndërmjetësimi në tregtinë me produkte speciale” dhe “ndërmjetësimi në tregtinë me produkte të ndryshme”.

15. Ankuesi thekson se në shtator 2001 ai kërkoi nga Komandanti i KFOR-it në Gjilan informacione se si mund të merr licencë për tregtimin e municionit për pushkë gjuetie, meqë KFOR-i i kishte lëshuar atij autorizimin për armë për posedimin e

një pushke private më 28 janar 2001. KFOR-i raportohet ta ketë referuar ankuesin në Policinë e UNMIK-ut. Ankuesi pohon se një komandant regjional i Policisë së UNMIK-ut i tha atij se Policia e UNMIK-ut nuk ishte autoriteti kompetent për lëshimin e licencës për tregtimin e municionit për gjueti, dhe i sugjeroi që ankuesi t'i drejtohet Administratës së UNMIK-ut.

16. Më 4 tetor 2001 administratori komunal i UNMIK-ut në komunën e Gjilanit i dërgoi një certifikatë KFOR-it, Policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Doganor, duke treguar se ankuesi është pronari i "Top Gun" dhe se biznesi i tij ishte i regjistruar. Në certifikatë thuhej:

> "Konfirmohet se biznesi aprovohet dhe personi autorizohet që të merret me furnizimin e pajisjeve për aktivitete sportive dhe të gjuetisë. Së këndejmi atij i lejohet që të blejë dhe shesë artikuj gjuetie siç janë plumbat, harqet e gjuetisë, shigjetat, kurthet, thikat, pajimet e peshkimit dhe gjëra të tjera të nevojshme që shoqërohen me gjuetinë dhe qitjen.
>
> Për aktivitetet e biznesit kërkohet që ai të importojë artikujt e duhur të pajisjeve."

17. Më 16 tetor 2001, ankuesi paraqiti njoftimin për ndryshimin e biznesit të tij, duke theksuar se ai e kishte ndryshuar strukturën e kompanisë dhe e kishte riemërtuar "N.P.T. Top Gun". Atij i kishin lëshuar certifikatë të re regjistrimi më 18 dhjetor 2001.

18. Më 25 korrik 2002, administratori komunal i UNMIK-ut në komunën e Gjilanit i dërgoi një certifikatë tjetër KFOR-it, Policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Doganor, duke konfirmuar informacionet e lartcekura, duke sqaruar se leja ishte lëshuar për "një periudhë të pacaktuar deri (*sic*) sa zotëria ta drejtojë biznesin e tij".

19. Ankuesi thekson se nga koha kur i filloi aktivitetet e tij komerciale, ai u mbështet në certifikatat e lëshuara nga administratori komunal i UNMIK-ut në komunën e Gjilanit, dhe kur ai paguante taksat doganore për municionin e importuar nga Shqipëria, Italia dhe Serbia, ai e informonte Policinë e UNMIK-ut për këtë tek selia e saj dhe në Gjilan.

20. Me kërkesë të Prokurorit Ndërkombëtar të Prokurorisë së Qarkut në Gjilan, më 24 tetor 2002, një gjyqtar hetues ndërkombëtar i Gjykatës së qarkut në Gjilan lëshoi urdhër për bastisje kundër ankuesit. Sipas urdhrit për bastisje, ankuesi dyshohej për posedim dhe shfrytëzim të paautorizuar të armëve, duke shkelur Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/07 të datës 21 shkurt 2001 për lejimin e posedimit të armëve në Kosovë. Gjyqtari ndërkombëtar autorizoi bastisjen për armë, për municion, dhe për substanca që mund të digjen në shtëpinë e ankuesit, tek biznesi i tij dhe në veturat e tij, ose në veturat dhe lokalet afër pronave që janë cituar në urdhër. Me urdhër u lejua edhe bastisja për dokumente të caktuara, për disqe të kompjuterit, etj., duke mbuluar periudhën prej 4 tetor 2001 deri në datën e bastisjes. Policia e UNMIK-ut me urdhër u autorizua të konfiskojë çfarëdo sendi të rëndësishëm për hetimin që gjendej gjatë bastisjes.

21. Më 29 tetor 2002, Policia e UNMIK-ut bastisi lokalet përkatëse në prani të ankuesit. Atij ia prezantuan kopjen e urdhrit për bastisje të datës 24 tetor 2002. Gjatë bastisjes, Policia e UNMIK-ut i ofroi ankuesit një shkresë, të datës 25 tetor 2002, të nënshkruar nga administratori komunal i UNMIK-ut në komunën e Gjilanit, duke iu referuar një dokumenti të nënshkruar nga ai më 27 maj 2002 (*sic)* në të cilin thuhej se ai "nuk kishte të drejtë të lëshojë një licencë të tillë apo leje" (të shesë municion dhe pajime të tjera për gjueti) dhe se ankuesi këtë "leje duhet konsideruar të pavlefshme". Policia e UNMIK-ut konfiskoi tërë municionin dhe dokumentet e biznesit të cilat ankuesi i ruante të dyqanin e tij, dhe atij i siguroi një listë me sendet e konfiskuara, duke konfirmuar se ishin konfiskuar më shumë se 50,000 fishekë si dhe një sërë dokumentesh dhe të dhënash për biznesin e tij. Sipas ankuesit, ata e gjetën edhe pushkën e tij të gjuetisë, por meqë ai kishte leje valide për mbajtje të armëve të UNMIK-ut për të, nuk ia konfiskuan. Policia e UNMIK-ut e morri në pyetje ankuesin dhe kërkoi që ai të ndërpriste çfarëdo urdhrash tjerë për municion dhe të informonte policinë për arritjen e dërgesave të mallit që ai priste të arrijnë. Ankuesi në fakt tregoi se ai ishte në pritje të një kontingjenti të ri me municion të cilën e kishte porositur nga një kompani në Serbi.

22. Më 30 tetor 2002, ankuesi urdhëroi katër dyqanet e tij jashtë Gjilanit të ndërpresin shitjen e municionit.

23. Më 1 nëntor 2002, ankuesi i dërgoi një shkresë Policisë së UNMIK-ut duke kërkuar licencë të re për shitjen e municionit të gjuetisë. Siç duket nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë kërkesë. Ankuesi thekson se ishte informuar për përgatitjen e një urdhërese administrative nga PSSP-ja, që do të trajtonte çështjen e furnizimit dhe shitjes së municionit të gjuetisë.

24. Më 5 nëntor 2002, ankuesi u paraqit në Policinë e UNMIK-ut dhe tregoi se dërgesa e municionit, që ishte porositur para bastisjes në lokalet e tij, do të arrinte në Kosovë më 6 nëntor 2002. Kur dërgesa me 182,250 fishekë arriti në kufi, në fakt më 7 nëntor 2002, Policia e UNMIK-ut e konfiskoi municionin. Sipas ankuesit, municioni i konfiskuar ishte dërguar në bazën e KFOR-it amerikan në "Kampin e Bondstillit" ("Camp Bondsteel") për ruajtje të përkohshme. Policia e UNMIK-ut lëshoi një listë të sendeve të konfiskuara. Nga ajo listë shihet se janë konfiskuar 182,250 fishekë gjuetie, të cilët gjithsej peshonin 7,290 kg.

25. Po ashtu, në fillim të nëntorit 2002, ankuesi e informoi Policinë e UNMIK-ut se pas sugjerimit të Policisë, e tërë sasia e mbetur e municionit të gjuetisë në dyqanet e tij jashtë Gjilanit ishte mbledhur dhe ishte vendosur në dyqanin e Gjilanit. Më 12 nëntor 2002, Policia e UNMIK-ut konfiskoi 4,072 fishekët që ishin kthyer dhe sërish ankuesit i siguroi një listë të sendeve të konfiskuara.

26. Më 28 dhjetor 2002, një gjyqtar hetues ndërkombëtar i Gjykatës së qarkut në Prishtinë lëshoi një urdhër tjetër për bastisje të shtëpisë dhe automjeteve të ankuesit. Më 22 dhe 27 janar 2003, ky urdhër u ekzekutua. Me këtë rast u konfiskuan edhe 841 dhe 230 fishekë të tjerë.

27. Më 10 prill 2003, avokatët e ankuesit i shkruan kryetarit të Gjykatës së qarkut në Gjilan, duke kërkuar kthimin e mallrave të konfiskuara. Në atë shkresë ata

theksuan se Prokurorja publike ndërkombëtare i kishte thënë ankuesit se ajo nuk planifikonte të iniciojë ndonjë procedurë penale kundër ankuesit meqë nuk kishte baza për ta bërë këtë. Avokatët pohuan se, meqë prokurorja nuk kishte gjetur dëshmi për ndonjë vepër penale, neni 209 i Ligjit të procedurës penale (LPP) të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ) (*Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr. 26/86*), në fuqi në atë kohë në mbështetje të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 mbi ligjin në fuqi në Kosovë, parasheh kthimin e menjëhershëm të pronës së konfiskuar.

28. Gjithashtu, më 10 prill 2003, avokatët e ankuesit i shkruan Prokurores ndërkombëtare e cila kishte kërkuar urdhrin për bastisje dhe nga ajo kërkuan që municioni t'i kthehet ankuesit, duke theksuar se ky i fundit do t'i përmbushë dispozitat përkatëse të Urdhëresës administrative të UNMIK-ut nr. 2003/1 të datës 17 janar 2003 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 për lejimin e posedimit të armëve në Kosovë, lidhur me ruajtjen e municionit të tillë. Avokatët e ankuesit iu referuan bisedës që kishin pasur me Prokuroren ndërkombëtare lidhur me mungesën e bazës ligjore për ta ndjekur penalisht ankuesin. Ata theksuan se shkatërrimi i municionit do t'i shkaktonte dëme të pakthyeshme ankuesit. Një shkresë e ngjashme ju kishte dërguar gjyqtarit hetues ndërkombëtar po atë ditë, i cili kishte urdhëruar bastisjen.

29. Më 6 qershor 2003, ankuesi i shkroi Policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës, duke dhënë hollësitë e ngjarjeve të sipërme, dhe sërish duke kërkuar licencë për shitjen e municionit për gjueti. Ankuesi theksoi se gjatë një bisede të mëhershme me Prokuroren publike ndërkombëtare të UNMIK-ut, e cila ishte e ngarkuar me hetimin penal, më 26 mars 2003, ai u informua nga ajo se municioni kishte gjasa të shkatërrohej.

30. Më 20 qershor 2003, Policia e UNMIK-ut në Gjilan iu përgjigj ankuesit, duke i treguar se "Rregullorja për legalizimin e dyqaneve për shitjen e municionit dhe pajimeve të tjera për gjueti është në proces e sipër".

31. Më 10 shkurt 2004, një organizatë joqeveritare (OJQ) iu drejtua me një shkresë zyrës për çështje ligjore të UNMIK-ut në emër të ankuesit, duke e informuar atë për gjendjen e vështirë financiare të ankuesit, i cili duhej t'i paguante bankës për kredinë që ia kishin siguruar për të blerë municionin e konfiskuar më 7 nëntor 2002. OJQ-a theksoi se ankuesi e kishte blerë municionin pasi e kishte marrë lejen nga administratori komunal i UNMIK-ut, dhe se Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/47 e datës 18 gusht 2000 mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë ndalojnë çfarëdo mjeti juridik kundër UNMIK-ut apo administratorit të tij komunal. OJQ-ja kërkoi nga UNMIK-u të ndërmerr hapa për zgjidhjen e gjendjes, dhe në veçanti të mundësojë lirimin e municionit që mbahej në Kampin Bondstill, ashtu që ankuesi të mund ta shiste. Paneli nuk e din nëse ka pasur përgjigje në këtë shkresë.

32. Më 29 prill 2004, Ombudspersoni ndërkombëtar i tha Zëvendës PSSP-së për Polici dhe Drejtësi se nuk mund të gjente ndonjë rregull ligjore që ndalonte shitjen e municionit dhe pajimeve për gjueti. Ai e ftoi Zëvendësin e PSSP-së të tregojë dispozitat ligjore në të cilat ishte mbështetur UNMIK-u për t'ia refuzuar ankuesit

të drejtën për t'u marrë me këtë tregti. Në një shkresë të datës 16 dhjetor 2004, Zëvendësi kryesor i PSSP-së u përgjigj si vijon:

> "[Pronësia], kontrolli, posedimi dhe përdorimi i armëve në Kosovë për *çfarëdo* qëllimesh, duke përfshirë edhe tregtinë, u nënshtrohen kushteve dhe kufizimeve të rrepta të paraqitura nga UNMIK-u në legjislacionin e tij në pajtim me mandatin e dhënë.
>
> Kjo para së gjithash është çështje e sigurisë dhe duhet trajtuar në përputhje me rrethanat.
>
> Në pritje të zhvillimeve të vazhdueshme dhe finalizimit të kornizës gjithëpërfshirëse legjislative për gjuetinë, dhe duke iu nënshtruar një vendimi autoritar se ekzistojnë kushtet e nevojshme të sigurisë, aktivitetet e gjuetisë në Kosovë në fakt janë të pezulluara.
>
> Nëse plotësohen të gjitha kushtet për lejimin e aktiviteteve të gjuetisë në Kosovë dhe këtë e lejon edhe ambienti i sigurisë, mund të përdoret një Rregullore e UNMIK-ut për rregullimin e tregtisë dhe importimit të armëve për gjueti, duke përfshirë edhe municionin dhe pajimet" (theksim në origjinal).

33. Gjatë disa viteve, nuk ka pasur zhvillime të mëtejshme. Më 18 qershor 2008, ankuesi iu drejtua me një shkresë kryetarit të Gjykatës së qarkut në Gjilan dhe në Prishtinë, si dhe prokurorëve publikë ndërkombëtarë dhe prokurorëve publikë të qarkut në Gjilan dhe në Prishtinë. Ai i përmblodhi të gjitha faktet e lëndës së tij dhe ata i pyeti nëse kishte ndonjë procedurë ligjore në pritje kundër tij në gjykatat përkatëse apo në prokuroritë, lidhur me konfiskimin e municionit për gjueti.

34. Kryetari i Gjykatës së qarkut në Gjilan e ofroi përgjigjen e tij më 23 qershor 2008, duke thënë se ndaj ankuesit nuk ishte ngritur asnjë lëndë penale në këtë gjykatë. Me një shkresë të datës 24 qershor 2008, prokurori publik i qarkut në Gjilan po ashtu theksoi se rasti i ankuesit nuk kishte kaluar nëpër zyrën e tij. Mirëpo, prokurori publik shtoi se lënda ka mundësi të jetë marrë për t'u shqyrtuar nga prokurorët ndërkombëtarë, dhe se për këtë arsye shkresat e ankuesit drejtuar Prokurorit publik ndërkombëtar të qarkut ju kishin dërguar Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut në Prishtinë, që mbikëqyrte punën e prokurorëve ndërkombëtarë.

35. Më 22 korrik 2008, prokurori publik i qarkut në Prishtinë i dërgoi ankuesit "thirrje gjyqësore për hetimin paraprak" në rastin penal kundër tij, si person i "akuzuar". Ankuesi ishte thirrur të paraqitet më 30 korrik 2008. Në atë datë, ankuesi dhe avokati i tij kishin pasur një takim me prokurorin publik të Prokurorisë speciale të Kosovës (më tutje në tekst: "Prokurori Special") dhe me një staf tjetër ndërkombëtar të UNMIK-ut. Të dy zyrtarët konfirmuan se nuk kishte pasur akuza penale kundër ankuesit. Ata gjithashtu premtuan se ankuesi do të merrte komunikatë zyrtare lidhur me municionin e konfiskuar, që sipas tyre ka mundur edhe të jetë shkatërruar.

36. Më 8 gusht 2008, Prokurori special miratoi aktvendimin me të cilin kallëzimi penal kundër ankuesit u hodh poshtë, duke u bazuar në faktin se nuk kishte arsye për dyshim se ankuesi kishte bërë ndonjë shkelje. Prokurori special theksoi se hetimi kundër ankuesit ishte iniciuar nga Policia e UNMIK-ut mbi bazën e një kallëzimi penal të pranuar nga Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë, të datës 3 maj 2002, që vinte në pikëpyetje vlefshmërinë e licencës që iu kishte dhënë ankuesit. Duke marrë parasysh faktin se ankuesi veproi sipas licencës për drejtimin e veprimtarisë së tij afariste të furnizimit dhe shitjes së pajimeve të gjuetisë, Prokurori special erdhi në përfundim se "në kohën kur ai e ushtronte veprimtarinë e tij ai kishte një licencë valide, dhe aktiviteti i tij nuk mund të konsiderohet i paligjshëm". Më 12 shtator 2008, ankuesi u njoftua për këtë aktvendim.

37. Më 22 shtator 2008, ankuesi i dërgoi ankesë Prokurorit special lidhur me aktvendimin, me të cilën kërkonte sqarime përse lënda e tij ishte mbajtur në zyrën e prokurorit për gjashtë vite para se të hidhej poshtë. Ankuesi gjithashtu pohoi se ishin bërë një sërë shkeljesh të Kodit të (të ri) Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (KPPPK), të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26 të datës 6 korrik 2003. Ai kërkoi që t'i kthehen dokumentacioni dhe municioni i konfiskuar. Nëse mallrat e konfiskuara, që ishin dërguar në selinë e kontingjentit amerikan të KFOR-it në "Kampin Bondstill", ishin shkatërruar, ashtu siç ishte thënë në takimin e mbajtur më 22 korrik 2008, ai kërkoi informacione të detajuara lidhur me bazën ligjore për një shkatërrim të tillë. Sipas ankuesit, ai nuk ka marrë përgjigje në shkresën tij.
38. Më 19 nëntor 2008, ankuesi vdiq.

39. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

40. Më 4 shkurt 2009, përfaqësuesi i trashëgimtarëve të ankuesit ju drejtua me një shkresë prokurorëve të EULEX-it të cilët punonin në Prokurorinë speciale të Kosovës, duke kërkuar komentet e tyre mbi çështjen e ngritur në shkresën e ankuesit të datës 22 shtator 2008. Prokurori i EULEX-it i cili e drejtonte zyrën u përgjigj më 22 qershor 2009, duke thënë se zyra e tyre nuk ishte kompetente lidhur me shkatërrimin e pretenduar të mallrave të konfiskuara nga KFOR-i në "Kampin Bondstill". Në të njëjtën kohë, vëmendja e ankuesit ishte e përqendruar në faktin se, nëse ai konsideronte se ishin shkelur të drejtat e tij personale apo pronësore, ai mund të kërkonte kompensim nga autoritetet kompetente.

41. Përfaqësuesi i trashëgimtarëve u përgjigj duke i dërguar një shkresë tjetër Kryeprokurorit të EULEX-it dhe shefit e zëvendësshefit të komponentës së drejtësisë së EULEX-it më 25 korrik 2009, duke argumentuar se Prokuroria speciale e Kosovës, e cila vepronte nën EULEX-in duhej të posedonte tërë dokumentacionin që paraprakisht ishte mbajtur nga kjo zyrë kur ajo vepronte nën UNMIK-un, dhe prandaj duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet kërkesës së 22 shtatorit 2008. Përfaqësuesi insistoi veçanërisht në përgjigjen e pyetjes se çka

kishte ndodhur me municionin e konfiskuar, dhe kërkoi që të kthehen municioni dhe librat e kontabilitetit.

42. Kryeprokurori i EULEX-it u përgjigj më 8 shtator 2009 duke thënë se lënda e ankuesit konsiderohej e mbyllur në kohën kur u bë dorëzimi i lëndëve nga UNMIK-u në EULEX. Ai vazhdoi duke thënë se EULEX-i kishte gjetur një fascikëll në "ndërtesat e UNMIK-ut" në të cilën ishte vendosur një listë me sendet e konfiskuara dhe librat financiarë, por tha se ata nuk kishin shënime se çka kishte ndodhur me sendet e tilla pas vitit 2002. Ai po ashtu theksoi se EULEX-i nuk gjeti ndonjë vendim apo shënime lidhur me shkatërrimin e sendeve nga KFOR-, dhe se me gjasë është e nevojshme që pyetja t'i drejtohet drejtpërsëdrejti kontingjentit amerikan të KFOR-it, që pohohet se është përgjegjës për marrjen e shënimeve të tilla.

43. Në komentet e tyre të datës 25 shtator 2009, trashëgimtarët e informuan Panelin se ata në ndërkohë e kishin kontaktuar kontingjentin e KFOR-it amerikan lidhur me urdhrin për shkatërrimin e çdo dëshmie në lëndën e ankuesit. Pas kësaj Kontingjenti amerikan i KFOR-it u tha atyre që drejtpërsëdrejti të kontaktojnë institucionin në fjalë, përkatësisht UNMIK-un.

44. Si shtojcë të bashkëngjitur deklaratës së 25 shtatorit 2009, përfaqësuesi i trashëgimtarëve dorëzoi dy deklarata të nënshkruara nga shoqatat kosovare të gjuetisë, në të cilat thuhej se, nga shtatori 2009, nuk kishte mënyrë për marrjen e municionit për gjueti apo për qëllime sportive përmes rrugëve ligjore në Kosovë. Mënyra e vetme për sigurimin e municionit të tillë ishte përmes tregut të zi.

III. ANKESA

45. Në vendimin e datës 16 dhjetor 2010 mbi pranueshmërinë e ankesës, Paneli njoftoi se ankuesi i kishte paraqitur ankesat vijuese, përderisa ata kishin të bënin me shkeljen e të drejtave të tij të njeriut:

> "38. Ankuesi në veçanti ankohet se UNMIK-u shkeli të drejtën e tij për të gëzuar të drejtat e parapara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) pavarësisht nga statusi ndërkombëtar i territorit në të cilin jeton personi (neni 2 i DUDNJ), e drejta për të mos u diskriminuar dhe mbrojtja e barabartë para ligjit (neni 7 i DUDNJ), e drejta për mjet të efektshëm pranë një tribunali nacional (neni 8 i DUDNJ), dhe e drejta për të mos u privuar në mënyrë arbitrare nga prona (neni 17 i DUDNJ).
>
> 39. Përveç kësaj, ankuesi argumenton se UNMIK-u është përgjegjës për shkelje të së drejtës për dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme dhe e drejta për qasje në gjykatë, të garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e drejta për mjet të efektshëm të garantuar me nenin 13 të KEDNJ dhe e drejta për të mos u diskriminuar në gëzimin e të drejtave të tij të garantuara me nenin 14 të KEDNJ."

46. Nga ankesa fillestare si dhe nga komentet e mëvonshme të ankuesit rezulton se ankuesi në esencë ngrit tri çështje.

47. Ankuesi në radhë të parë argumenton se pas bastisjes fillestare dhe konfiskimit më 29 tetor 2002 nuk ishte bërë asnjë hetim për një kohë të gjatë, dhe nuk ishte marrë asnjë vendim për akuzat deri më 8 gusht 2008, kur kallëzimi penal kundër tij u hodh poshtë. Në këtë aspekt, ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për qasje në gjykatë dhe të drejtën për të marrë një vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

48. Ankuesi gjithashtu argumenton se konfiskimi i mallit të tij (municioni për gjueti dhe librat e kontabilitetit) nuk ishte i bazuar në ndonjë ligj dhe ai nuk kishte mjete në dispozicion që të ndalonte konfiskimin apo të merrte kompensim. Në këtë aspekt, ankuesi mund të konsiderohet se thirret në shkelje të së drejtës së tij për pronë, të garantuar me nenin 17 të DUDNJ dhe nenin 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ, dhe të drejtën e tij për mjet të efektshëm, të garantuar me nenin 8 të DUDNJ dhe nenin 13 të KEDNJ.

49. Përfundimisht, ankuesi argumenton se UNMIK-u veproi në mënyrë diskriminuese kundër tij dhe familjes së tij, duke shkelur nenin 7 të DUDNJ dhe nenin 14 të KEDNJ.

50. Paneli konsideron se nenet e DUDNJ të cilëve iu referuam në esencë kanë kuptimin e njëjtë sikurse nenet korresponduese të KEDNJ. Më tutje Paneli do të shqyrtojë ankesën duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të KEDNJ.

IV. LIGJI

A. Vërejtjet paraprake

51. Para se t'i kthehemi shqyrtimit të ankesës, Paneli dëshiron të sqarojë qëllimin e këtij shqyrtimi.

52. Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, parasheh që Paneli ka juridiksion vetëm për "ankesat që kanë të bëjnë me pohimin për shkelje të të drejtave të njeriut që kishin ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 ose që dalin nga faktet që janë paraqitur para kësaj date kur këto fakte paraqesin shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Si pasojë ngjarjet që ndodhën para 23 prillit 2005 përgjithësisht janë jashtë juridiksionit kohor të Panelit (*ratione temporis).* Nëse ngjarjet e tilla paraqesin një situatë që po vazhdon, Paneli ka juridiksion të shqyrtojë ankesat lidhur me situatën e tillë, por vetëm nëse situata ka vazhduar pas 23 prillit 2005**.**

53. Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 parasheh që Paneli të "shqyrtojë ankesat nga cilido person ose grup të individëve të cilët pretendojnë se janë viktimë e shkeljeve të të drejtave (të tyre) të njeriut të bëra nga UNMIK-u". Për rrjedhojë vetëm veprimet apo mosveprimet që i atribuohen UNMIK-ut janë në

kuadër të juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Në këtë aspekt duhet theksuar se më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë. Nga kjo rrjedh se pas 9 dhjetorit 2008, UNMIK-u më nuk ushtronte pushtet ekzekutiv mbi gjyqësorin e Kosovës dhe nuk kishte përgjegjësi për ndonjë shkelje të të drejtave të njeriut që pohohej se ishin bërë nga ata. Përderisa ankuesi ankohet për akte që kanë ndodhur pas kësaj date, ata janë jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit.

54. Më në fund, Paneli duhet potencuar se nga neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 del se ai mund të shqyrtojë vetëm ato ankesa që kanë të bëjnë me pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se mund të "shqyrtojë" veprimet apo mosveprimet për të cilat është paraqitur ankesë, në kuptim të asaj se mund të shqyrtojë pajtueshmërinë e tyre me standarde të caktuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Paneli nuk ka rolin që të merret me interpretimin dhe zbatimin e rregullave të tjera ligjore nga autoritetet gjyqësore, siç janë rregullat e ligjit penal dhe ligjit të procedurës penale. Aq më tepër, Paneli nuk është kompetent të vendosë për thelbin e asnjë ankese që ankuesi e ka paraqitur pranë një organi gjyqësor apo tjetër. Kjo vlen edhe për kërkesat për kompensim: Paneli nuk ka juridiksion të vendosë për kërkesat e tilla, edhe pse në rekomandimet e tij mund t'i referohet kompensimit si formë e reparacionit.

B. Pranueshmëria e ankesës

55. Në komentet e tij për pranueshmërinë e ankesës, PSSP-ja argumentoi se ankesa ishte e papranueshme për shkak të mos-shterimit të mjeteve në dispozicion. Së pari ai argumentoi se ankuesi kishte kërkuar nga Prokurori special kthimin e pasurisë dhe të dhënave për biznesin e tij. Meqë kërkesa e tij ishte në pritje për shqyrtim, ankuesi është dashur të priste rezultatin e saj para se të ankohet tek Paneli. Së dyti PSSP-ja argumentoi se, varësisht nga përgjigjja e Prokurorit special, ankuesi ndoshta do të duhet t'i qaset komunës së Gjilanit dhe/ose KFOR-it, "përmes procedurave të tyre administrative", për të marrë kompensimin.

56. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, Paneli "mund të merret me një çështje vetëm pasi të vendosë se janë ndjekur të gjitha rrugët tjera në dispozicion për shqyrtimin e shkeljeve të pohuara".

57. Në vendimin e tij për pranueshmëri të 16 dhjetorit 2010, Paneli theksoi se mjetet e sugjeruara nga PSSP-ja "nuk duket se janë të bazuara në ligj, ose së paku nuk ka një bazë të cilën UNMIK-u është në gjendje ta identifikojë" (§ 45). Paneli konstatoi se çështja e shterimit të mjeteve ishte ngushtë e lidhur me bazueshmërinë e ankesës së ankuesit dhe për këtë arsye bashkoi çështjen e pranueshmërisë me atë të bazueshmërisë, në pajtim me Rregullën 31*bis* të Rregullores së Punës së Panelit (§ 46).

58. Sa i përket ankesës drejtuar Prokurorit special, Paneli thekson se kjo është ankesë në instancën kur pohohet se ka qenë përgjegjës për hetimin dhe konfiskimin. Paneli nuk sheh se si një ankesë e tillë mund të ofrojë standarde adekuate për një shqyrtim të pavarur dhe të paanshëm të ankesave të ankuesit, para së gjithash drejtuar kundër veprimeve dhe mosveprimeve nga autoritetet e ndjekjes (krahaso Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), *Benyaminson kundër Ukrainës*, nr. 31585/02, aktgjykim i 26 korrikut 2007, § 117). Sido që të jetë, ankesa drejtuar Prokurorit Special nuk ka mundësi të ofrojë dëmshpërblim për sa i përket kohëzgjatjes së procedurës, dhe është dëshmuar se nuk ka mundësi të ofrojë dëmshpërblim lidhur me konfiskimin e mallrave që i përkasin ankuesit.

59. Sa u përket kërkesave drejtuar komunës së Gjilanit dhe/ose KFOR-it, PSSP-ja nuk ka treguar bazën ligjore për kërkesat e tilla. As Paneli nuk e sheh një bazë të tillë ligjore. Nga kjo del se efektiviteti i mjeteve të tilla nuk është konstatuar.

60. Prandaj, vërejtja e PSSP-së është hedhur poshtë, dhe ankesa është shpallur e pranueshme.

C. Bazueshmëria e ankesës

1. Procedura penale: shkelje e pohuar e së drejtës për qasje në gjykatë dhe e drejta për të marrë një vendim brenda një periudhe kohore të arsyeshme (neni 6 § 1 i KEDNJ)

a) Parashtresa e palëve

61. Ankuesi thekson se ishte dëmtuar rëndë nga procedura. Më 29 tetor 2002, pasuria e tij ishte konfiskuar në mënyrë armiqësore dhe licenca e tij për furnizim me municion të gjuetisë ishte anuluar. Për shkak të kësaj situate ishte kompromettuar edhe reputacioni i tij. Ai ankohet se nuk ishin bërë hetime, dhe deri më 8 gusht 2008 nuk ishte marrë asnjë vendim. Gjatë asaj kohe ai nuk kishte pasur qasje në gjykatë për të vendosur rastin e tij, ashtu siç është përshkruar në nenin 6 § 1 të KEDNJ.

62. Ankuesi gjithashtu ankohet se periudha gati gjashtëvjeçare ndërmjet fillimit të procedurës më 29 tetor 2002 dhe hedhjes poshtë të akuzave më 10 gusht 2008 përbën shkelje të kushtit për kohën e arsyeshme, të paraparë në nenin 6 § 1 të KEDNJ.

63. Ankuesi thekson se ai aktivisht ka bashkëpunuar me autoritetet. Në një sërë rastesh, ai iu drejtua autoriteteve gjyqësore dhe autoriteteve tjera duke kërkuar zgjidhjen e shpejtë të rastit të tij, duke pohuar se kjo situatë atij po i shkaktonte dëme të paripërueshme monetare dhe jo-monetare dhe ia përkeqësonte gjendjen e tij të rëndë shëndetësore. Kërkesat e tij u shpërfillën. Për më tepër, ankuesi pohon se gjyqtarët dhe prokurorët e UNMIK-ut nuk i respektuan afatet e përcaktuara me ligjin në fuqi.

64. PSSP-ja nuk e komenton këtë pjesë të ankesës.

b) Vlerësimi i Panelit

65. Në pjesën përkatëse të nenin 6 § 1 të KEDNJ thuhet:

> "Në marrjen e vendimit për ndonjë .....akuzë penale kundër një personi, çdokush ka të drejtë në dëgjim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme kohore nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar sipas ligjit […]."

1. Zbatimi i nenit 6 § 1 të KEDNJ

66. "Natyra kriminale" e procedurës në të cilën është i përfshirë ankuesi nuk mund të kontestohet. Në urdhrin për bastisje të lëshuar kundër ankuesit më 24 tetor 2002 thuhet se ai dyshohej për shkeljen e neneve 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7 të datës 21 shkurt 2001 për lejimin e posedimit të armëve në Kosovë. Posedimin, mbajtjen dhe përdorimin e armës këto dispozita e konsiderojnë "vepër penale" nëse [personi] nuk ka [leje valide për armëmbajtje] për atë armë" dhe po ashtu edhe "përdorimin apo vringëllimin e çfarëdo arme në mënyrë kërcënuese, kanosëse apo në ndonjë mënyrë tjetër të paautorizuar". Në aktvendimin e Prokurorit special të datës 8 gusht 2008 thuhet se ankuesi ishte i dyshuar për "pronësi, kontroll, posedim apo përdorim të paautorizuar të armëve", vepër penale e paraparë me nenin 328 (2) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25 të datës 6 korrik 2003), që në ndërkohë kishte zëvendësuar një numër të Rregulloreve të UNMIK-ut, duke përfshirë edhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/7.

67. Paneli duhet gjithashtu të vendosë nëse ankuesi mund të konsiderohet person nën "akuzë" për qëllimet e zbatimit të nenit 6 § 1 të KEDNJ. Për këtë çështje Paneli i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas të cilës një "akuzë", në kuptim të nenit 6 § 1, mund të përkufizohet si "njoftim zyrtar dhënë individit nga autoriteti kompetent për pohimin se ai ka kryer vepër penale", një përkufizim që gjithashtu korrespondon me testin nëse "gjendja e të (dyshuarit) është ndikuar në mënyrë të konsiderueshme" (GJEDNJ, *Deweer kundër Belgjikës,* aktgjykim i 27 shkurtit 1980, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 35, § 46; GJEDNJ, *Eckle kundër Gjermanisë,* aktgjykim i 15 korrikut 1982, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 51, § 73; GJEDNJ (Grand Chamber), *McFarlane kundër Irlandës*, nr. 31333/06, aktgjykim i 10 shtatorit 2010, § 143). Në rastin aktual, siç u tha më lart, në urdhrin për bastisje të 24 tetorit 2002 thuhet se ankuesi ishte i dyshuar për shkelje të neneve 8.2 dhe 8.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/7. Për më tepër, bastisjet, konfiskimi i pasurisë dhe anulimi i licencës së ankuesit për tregti të gjitha ndikuan në mënyrë të konsiderueshme në gjendjen e tij. Prandaj, Paneli konsideron se nga 29 tetori 2002, kur ankuesit iu dërgua urdhri për konfiskim i 25 tetorit 2002 dhe u bë bastisja e parë, ankuesi ishte nën "akuzë" për qëllimet e nenit 6 § 1 të KEDNJ. Ky konkludim nuk është ndryshuar nga fakti se kallëzimi penal kundër ankuesit përfundimisht ishte hedhur poshtë, as nga fakti se ai asnjëherë formalisht nuk kishte qenë i "akuzuar".

2. Përputhshmëria me nenin 6 § 1 të KEDNJ

a. Qasja në gjykatë

68. Neni 6 § 1 i KEDNJ përfshin të drejtën e të akuzuarit që akuzat kundër të tij të vendosen nga një tribunal i pavarur dhe i paanshëm i themeluar me ligj. Mirëpo, Paneli thekson se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund t'u nënshtrohet kufizimeve. Për këtë çështje Paneli përkujton në veçanti praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës pas ngritjes së akuzave penale nuk ka të drejtë, sipas nenit 6 të KEDNJ, për ndonjë rezultat të caktuar të procedurës penale ose dënim formal apo shfajësim (GJEDNJ, *Withey kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.* 59493/00, vendim i 26 gushtit 2003, KEDNJ, 2003-X; GJEDNJ (Grand Chamber), *Kart kundër Turqisë*, nr. 8917/05, aktgjykim i 3 dhjetorit 2009, § 68). Gjykata Evropiane pra ka pranuar se procedura mund të përfundohet me anë të një vendimi të njëanshëm të marrë në favor të personit të akuzuar për kundërvajtje, duke përfshirë edhe rastin kur prokurori formalisht vendos të mos ndjekë penalisht (shih, p.sh. GJEDNJ, *Deweer kundër Belgjikës*, cituar në § 67 lart, në § 49).

69. Për rrjedhojë, përderisa ankuesi ankohet për mungesën e qasjes në gjykatë për vendosjen e akuzave të ngritura kundër tij, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

b. Kohëzgjatja e procedurës

70. Sipas nenit 6 § 1 të KEDNJ, të gjithë kanë të drejtë në marrjen e një vendimi "brenda një kohe të arsyeshme" për një akuzë penale të ngritur kundër tij.

71. Njëri prej qëllimeve për të drejtën në gjykim brenda një kohe të arsyeshme është që të mbrojmë individët të mos "mbesin një kohë shumë të gjatë në gjendje të pasigurisë për fatin e tyre" (shih GJEDNJ, *Stögmüller kundër Austrisë*, aktgjykim i 10 nëntorit 1969, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 9, § 5; GJEDNJ, *Withey kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar në § 68 lart).

Periudha që duhet marrë parasysh

72. Në lëndët penale, "koha e arsyeshme" të cilës i referohemi në nenin 6 § 1 fillon të ecë posa të jetë "akuzuar" personi. Në përputhje me këtë, procedura penale konsiderohet se ka filluar me "njoftimin zyrtar dhënë individit nga autoriteti kompetent për pohimin se ai ka kryer vepër penale", një përkufizim që gjithashtu korrespondon me verifikimin nëse "gjendja e (të dyshuarit) është ndikuar në mënyrë të konsiderueshme" (shih § 67 lart, me referenca të tjera).

73. Paneli konsideron se procedura kundër ankuesit filloi më 29 tetor 2002, kur ai ishte njoftuar për bastisjen e parë dhe për urdhrin për konfiskim bazuar në pohimin se ai kishte kryer vepër penale. Gjendja e ankuesit ishte ndikuar deri në atë shkallë që të mund të përbënte një "akuzë". Mirëpo, periudha që duhet marrë parasysh fillon nga data e juridiksionit kohor të Panelit, që është 23 prill 2005 (shih § 52 lart). Gjatë vlerësimit të arsyeshmërisë së periudhës kohore që ka kaluar pas 23 prillit 2005, Paneli megjithatë do të merr parasysh gjendjen e procedurës në atë moment (GJEDNJ, *Foti dhe të Tjerët kundër Italisë*, aktgjykim i 10 dhjetorit 1982, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 56, p. 15, § 53; GJEDNJ, *Styranowski kundër Polonisë*, aktgjykim i 30 tetorit 1998, *Raportet e aktgjykimeve dhe*

vendimeve, 1998-VIII, f. 3376, § 46; shih gjithashtu Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut (HRAP), nr. 06/07, *Mitroviç*, mendim i 17 dhjetorit 2010, § 82).

74. Përgjithësisht, procedura penale përfundon me njoftimin zyrtar dërguar të akuzuarit se ai apo ajo më nuk ndiqet penalisht për ato akuza, në mënyrë që të lejohet marrja e një konkludimi se gjendja e atij personi nuk mund më të konsiderohet se është e ndikuar në mënyrë të konsiderueshme. Kjo në përgjithësi përfundon me lirim apo me dënim. Mirëpo, procedura gjithashtu mund të përfundohet me një vendim të njëanshëm të marrë në favor të të akuzuarit, duke përfshirë edhe rastet kur prokuroria informon të akuzuarin se e ka ndërprerë procedurën kundër tij (shih GJEDNJ, *Slezevicius kundër Lituanisë*, nr. 55479/00, aktgjykim i 13 nëntorit 2001, § 27; GJEDNJ, *R. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, vendim i 4 janarit 2007, nr. 33506/05; GJEDNJ, *Niedermeier kundër Gjermanisë*, nr. 37972/05, vendim i 3 shkurtit 2009). Në rastin aktual, Paneli konsideron se procedura përfundoi më 12 shtator 2008, kur ankuesi është njoftuar për aktvendimin e Prokurorit special me të cilin ai hedh poshtë kallëzimin penal kundër tij.

75. Pra kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës ishte pesë vite, dhjetë muaj dhe katërmbëdhjetë ditë, ku nga këto tri vite, katër muaj dhe njëzet ditë duhet të shqyrtohen nga Paneli.

Arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës

76. Paneli përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet vlerësuar duke u bazuar në rrethanat e rastit dhe duke iu referuar kritereve vijuese: ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e ankuesit dhe e autoriteteve relevante dhe në çfarë aspekti rrezikohej ankuesi në këtë kontest (shih, në mesin e shumë autoriteteve të tjera, GJEDNJ (Grand Chamber), *Frydlender kundër Francës* nr. 30979/96, aktgjykim i 27 qershorit 2000, § 43, KEDNJ, 2000-VII; shih gjithashtu PKDNJ (HRAP), nr. 17/08, *Emini*, mendim i 18 qershorit 2010, § 21).

77. Paneli konsideron se rasti në veçanti, nuk ishte i ndërlikuar pavarësisht nga paqartësia për disa çështje juridike të përfshira në këtë lëndë.

78. Paneli gjithashtu thekson se ankuesi nuk ka kontribuar në asnjë mënyrë në kohëzgjatjen e procedurës, dhe në fakt rregullisht ka kërkuar informacione për gjendjen e procedurave.

79. Sa i përket sjelljes së autoriteteve, Paneli thekson se ka pasur një vonesë të konsiderueshme në mes të ekzekutimit të bastisjes dhe urdhrave për konfiskim më 29 tetor 2002, 7 dhe 12 nëntor 2002, 22 dhe 27 janar 2003) dhe aktvendimit me të cilin kallëzimi penal kundër ankuesit është hedhur poshtë (8 gusht 2008). Në veçanti, fare nuk ka indikacion për ndonjë aktivitet të ndërmarrë nga prokurori publik ndërmjet 20 qershorit 2003 dhe 22 korrikut 2008. Përafërsisht gjysma e kësaj periudhe është në juridiksionin kohor të Panelit. Paneli gjithashtu thekson se vendimi për ndërprerje i datës 8 gusht 2008 nuk tregon se është marrë në bazë të informacioneve shtesë të mbledhura gjatë hetimit.

80. Përfundimisht, Paneli konsideron se interesat e ankuesit që janë vënë në rrezik në procedurë, përkatësisht vlera e konsiderueshme ekonomike e sendeve të konfiskuara, efektet mbi mundësinë e vazhdimit të veprimtarisë së tij afariste dhe dëmtimin e mundshëm të reputacionit të tij, ishin të atilla që kërkonin zbatim të kujdesshëm dhe të përshpejtuar të hetimeve.

81. Duke pasur parasysh sa u tha më lart, dhe në veçanti mënyrën si u rrezikua ankuesi, Paneli konkludon se kohëzgjatja e procedurës pas 23 prillit 2005 ishte e tepërt dhe nuk u përmbush kushti për "kohën e arsyeshme".

82. Në përputhje me këtë, Paneli mendon se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të KEDNJ.

2. Masat për konfiskim

a. Pohimi për shkelje të së drejtës për pronë (neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ)

1. Parashtresa e palëve

83. Ankuesi, në radhë të parë, pohon se UNMIK-u në mënyrë të paligjshme e konfiskoi pasurinë e tij. Ai argumenton se procedurat penale kundër tij nuk ishin të bazuara në ligj. Ai thekson se ai e kishte blerë municionin e konfiskuar duke u mbështetur në licencën e lëshuar nga administratori i UNMIK-ut, që në atë kohë ishte "ligjore dhe valide", siç është pranuar edhe me aktvendimin e Prokurorit special të datës 8 gusht 2008. Ankuesi gjithashtu argumenton se dispozitat penale të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/07 të datës 21 shkurt 2001 mbi lejimin e posedimit të armëve në Kosovë ishin zbatuar gabimisht nga autoritetet hetuese në këtë rast. Sipas ankuesit, shtrirja e Rregullores ishte e kufizuar në (pronësi, posedim dhe kontroll personal të armëve) që duhej të autorizoheshin nga policia, dhe nuk shtrihej që të mbulonte tregtimin e municionit për aktivitete rekreative. Sipas mendimit të ankuesit, për këtë qëllim ai kishte vepruar në përputhje me kornizën rregullative që kishte ekzistuar para UNMIK-ut (Ligji mbi armët dhe municionin, *Gazeta zyrtare e Republikës së Serbisë*, nr. 9/92; Ligji mbi marrjen, posedimin dhe bartjen e armëve dhe municionit, *Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, nr.* 40/80; Ligji për gjuetinë, *Gazeta zyrtare e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës*, nr. 37/79) i zbatueshëm me anë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 12 dhjetor 1999 për ligjin në fuqi në Kosovë.

84. Në radhë të dytë ankuesi ankohet se pas hedhjes poshtë të akuzave kundër tij, autoritetet e UNMIK-ut nuk i kthyen mallrat e konfiskuara gjatë hetimit, siç u parapa me ligj. Ai thekson se pasuria e tij ende mbetet e konfiskuar. Gojarisht ai është informuar nga autoritetet se mallrat e konfiskuara mund të jenë shkatërruar nga KFOR-i.

85. PSSP-ja nuk komenton bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës.

2. Vlerësimi i Panelit

86. Në nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ thuhet:

"Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë të gëzojë në mënyrë të papenguar pronën e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij përveç kur është në interesin publik dhe i nënshtrohet kushteve të parapara me ligj dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Mirëpo, dispozitat paraprake në asnjë mënyrë nuk do të cenojnë të drejtën e shtetit për zbatimin e ligjeve të tilla kur e konsideron të nevojshme të kontrollojë shfrytëzimin pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm, apo për të siguruar pagimin e taksave apo kontributeve të tjera ose dënimeve."

87. Konfiskimi i municionit për gjueti dhe i librave të kontabilitetit të ankuesit përbënte ndërhyrje në të drejtën e tij për mbrojtje të pronës. Prandaj, në këtë rast zbatohet neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

88. Sa i përket identifikimit të rregullës së zbatueshme, Paneli përkujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

> "… Neni 1 i Protokollit nr. 1 përfshin tri rregulla të ndryshme: rregulla e parë, e paraqitur në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është e një natyre të përgjithshme dhe paraqet parimin e gëzimit të papenguar të pronës; rregulla e dytë, e përfshirë në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimin e pasurisë dhe kjo pasuri u nënshtrohet kushteve të caktuara; rregulla e tretë, e paraqitur në paragrafin e dytë, pranon se shtetet kontraktuese kanë të drejtë, në mesin e gjërave të tjera, të kontrollojnë shfrytëzimin e pasurisë në pajtim me interesin e përgjithshëm. Mirëpo, të tri rregullat nuk janë të ndryshme në kuptimin që të jenë të shkëputura. Rregulla e dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me raste të caktuara të ndërhyrjes në të drejtën e gëzimit të papenguar të pronës, dhe prandaj duhet të interpretohen nga pikëpamja e parimit të përgjithshëm të paraqitur në rregullën e parë" (shih p.sh., GJEDNJ (Grand Chamber), *Perdigao kundër Portugalisë*, nr. 24768/06, aktgjykim i 16 nëntorit 2010, § 57).

89. Paneli gjithashtu i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut sipas së cilës konfiskimi i përkohshëm (ose marrja) i pasurisë, që ruhet si dëshmi në një rast penal, edhe pse ka të bëjë me privimin e posedimit, megjithatë është kontroll i shfrytëzimit të pasurisë, në kuptim të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (shih GJEDNJ, *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykim i 24 tetorit 1986, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 108, § 51; GJEDNJ, *Raimondo kundër Italisë*, aktgjykim i 22 shkurtit 1994, *Publikime të gjykatës*, Seria A, nr. 281-A, § 27).

90. Kushti i parë dhe më i rëndësishëm i nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ është se çdo ndërhyrje e një autoriteti publik në gëzimin e papenguar të pronës duhet të jetë e ligjshme. Në veçanti, paragrafi i dytë i nenit 1, përderisa e pranon se shtetet kanë të drejtë të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës, ushtrimin e kësaj të drejte të tyre e kushtëzon me zbatimin e "ligjeve" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Hutten-Czapska kundër Polonisë*, nr. 3501/97, aktgjykim i 19 qershorit 2006, § 163, KEDNJ, 2006-VIII). Gjithashtu, ndërhyrja duhet të ndjekë një qëllim legjitim që është në "interesin e përgjithshëm" të komunitetit. Përfundimisht, ndërhyrja duhet të arrijë një "ekuilibër të drejtë" në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të

komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave fundamentale të njeriut: duhet të ekzistojë një marrëdhënie e arsyeshme e raportit në mes të mjeteve të përdorura dhe qëllimit të ndjekur (GJEDNJ (Grand Chamber), *Depalle kundër Francës*, nr. 34044/02, aktgjykim i 29 marsit 2010, § 83).

91. Paneli konsideron se në rastin aktual, duhet bërë dallimin në mes të fazave të ndryshme të ndërhyrjes për të cilat është parashtruar ankesë: konfiskimi fillestar, periudha gjatë së cilës mallrat e ankuesit qëndruan të konfiskuara, d.m.th. nga konfiskimi i parë më 29 tetor 2002 deri në marrjen e aktvendimit nga Prokurori special më 8 gusht 2008, dhe gjendja e mallrave të konfiskuara pas marrjes së atij aktgjykimi.

92. Fillimisht, për sa i përket konfiskimit fillestar të mallrave, Paneli vërteton se pasuria e ankuesit ishte konfiskuar më 29 tetor 2002, 7 dhe 12 nëntor 2002, dhe më 22 dhe 27 janar 2003. Paneli përkujton se ka juridiksion për ankesat që kanë të bëjnë me pohimet për shkelje të të drejtave të njeriut, që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që dalin nga faktet që kanë ndodhur para kësaj date kur këto fakte përbëjnë shkelje të vazhdueshme (shih § 52 lart). Paneli konsideron se vetë akti i konfiskimit ishte akt i atypëratyshëm që është jashtë juridiksionit të tij kohor (*ratione temporis)* (shih GJEDNJ, *Karamitrov dhe të Tjerët kundër Bullgarisë*, nr. 53321/99, aktgjykim i 10 prillit 2008, § 71). Prandaj, Paneli nuk mund ta shprehë mendimin nëse vendimi për konfiskimin e pasurisë së ankuesit ishte i ligjshëm apo ka ndjekur një qëllim legjitim në interesin e përgjithshëm.

93. Gjithashtu, sa i përket vazhdimit të konfiskimit nga konfiskimi i parë më 29 tetor 2002 deri në marrjen e aktvendimit të Prokurorit special më 8 gusht 2008, Paneli konsideron se ky aspekt i ndërhyrjes në pasurinë e ankuesit duhet vlerësuar kryesisht nga pikëvështrimi i raportit të ndërhyrjes.

94. Në këtë aspekt, duhet marrë parasysh kohëzgjatjen e masës së konfiskimit, nevojën e saj varësisht nga zhvillimet e procedurës penale, dhe efektet e zbatimit të saj tek ankuesi (shih GJEDNJ, *Petyo Petkov kundër Bullgarisë*, nr. 32130/03, aktgjykim i 7 janarit 2010, § 105; GJEDNJ, *Georgi Atanasov kundër Bullgarisë*, nr. 5359/04, aktgjykim i 7 tetorit 2010, § 31).

95. Paneli thekson se periudha që është nën shqyrtim vazhdoi për pesë vite, nëntë muaj dhe nëntë ditë, nga të cilat tri vite, tre muaj dhe pesëmbëdhjetë ditë ishin në juridiksionin e tij kohor (*ratione temporis).* Paneli tanimë veç ka konstatuar se procedura penale në relacion me të cilën janë marrë masat për konfiskim nuk ka përmbushur kushtin për "kohën e arsyeshme" të nenit 6 § 1 të KEDNJ (shih § 81 lart). Kohëzgjatja e procedurës penale në masë të madhe përputhet me kohëzgjatjen e masave për konfiskim.

96. Gjithashtu, nuk duket se janë marrë masa për ndonjë hetim pas konfiskimit të mallrave (shih § 79 lart). Prandaj, Paneli duhet të gjykojë se nuk është konstatuar se masat e konfiskimit ishin të arsyeshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit që e ndiqnin autoritetet gjyqësore.

97. Për më tepër, mallrat e konfiskuara kishin një vlerë të konsiderueshme komerciale për ankuesin (shih § 80 lart).

98. Paneli konkludon se autoritetet kompetente nuk e bënë baraspeshimin në mes të cilësdo kërkese të interesit publik dhe kërkesës për mbrojtjen e të drejtës së ankuesit në gëzim të papenguar të pasurisë së tij me mbajtjen e masës për konfiskim në fuqi për më shumë se tri vite pas fillimit të periudhës për të cilën Paneli ka juridiksion (krahaso GJEDNJ, *Borzhonov kundër Rusisë*, nr. 18274/04, aktgjykim i 22 janarit 2009, §§ 60-61).

99. Përfundimisht, sa i përket gjendjes pas aktvendimit të Prokurorit special të datës 8 gusht 2008, Paneli thekson se ankuesi argumenton se autoritetet në mënyrë të paligjshme kanë mbajtur sendet e konfiskuara që nga mbyllja e hetimeve deri më sot. Paneli konsideron se konfiskimi që ka vazhduar edhe pas hedhjes poshtë të akuzave paraqet gjendjen në vazhdimësi, e cila është nën juridiksionin kohor të Panelit. Mirëpo, përgjegjësia e UNMIK-ut për sjelljen e autoriteteve gjyqësore përfundoi më 8 dhjetor 2008 (shih § 53 lart). Gjendja pas kësaj date është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit. Për rrjedhojë, Paneli duhet të kufizojë rishqyrtimin e tij për periudhën ndërmjet 8 gushtit 2008 dhe 8 dhjetorit 2008.

100. Paneli thekson se neni 215 i Ligjit mbi procedurën penale (LPP) i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (shih § 27 lart) përshkruan kthimin e sendeve të konfiskuara në fund të hetimit:

> "Sendet e konfiskuara përkohësisht gjatë kohëzgjatjes së procedurës penale i kthehen pronarit ose personit që i ka në posedim nëse procedura pushon dhe më nuk ekzistojnë arsye për konfiskimin e tyre (neni 500)."

101. Duket se kjo dispozitë vazhdoi të jetë e zbatueshme për hetimin e rastit të ankuesit edhe pas hyrjes në fuqi të Kodit të Përkohshëm të (ri) Procedurës Penale të Kosovës (më 6 prill 2004) (KPPPK) (shih § 37 lart), duke u mbështetur në dispozitën kalimtare të nenit 549 të KPPPK. Sido që të jetë, neni 251 i KPPPK vazhdon të parashohë kthimin e sendeve të konfiskuara përkohësisht "pronarit ose poseduesit nëse procedura është pezulluar apo përfunduar dhe nuk ka më arsye për konfiskimin e tyre (neni 489 i Kodit aktual)".

102. Mallrat e konfiskuara përkohësisht nuk iu kthyen ankuesit në fund të procedurës penale. Aktvendimi i Prokurorit special i datës 8 gusht 2008 në asnjë mënyrë nuk i referohet gjendjes së këtyre mallrave. As nuk ka aktvendim të veçantë në bazë të nenit 500 të LPP apo nenit korrespondues 489 të KPPPK, që do të urdhëronte konfiskimin e vazhdueshëm të mallrave, pavarësisht nga përfundimi i procedurës penale pa një verdikt me të cilin ankuesi shpallet fajtor.

103. Prandaj, Paneli duhet të konkludojë se nuk ka pasur bazë sipas ligjit në fuqi për moskthimin e mallrave të konfiskuara përkohësisht ankuesit. Kështu që Paneli konkludon se mbajtja e vazhdueshme e municionit të gjuetisë dhe e librave të kontabilitetit pas përfundimit të procedurës penale ishte e paligjshme (shih GJEDNJ, *Borzhonov kundër Rusisë*, cituar në § 98 lart, në § 62).

104. Konstatimi se ndërhyrja në të drejtën e ankuesit në gëzimin e papenguar të pronës së tij ishte e paligjshme e bën të panevojshme shqyrtimin e aspekteve të

tjera sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ, duke përfshirë edhe nëse është bërë një ekuilibër i drejtë në mes të kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtjen e të drejtave fundamentale të individit.

105. Prandaj ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

b. Pohimi për shkelje të së drejtës për mjet të efektshëm (neni 13 i KEDNJ)

1. Parashtresa e palëve

106. Ankuesi ankohet për mungesën e një mjeti të efektshëm lidhur me konfiskimin e mallrave të tij. Ai argumenton se gjatë dhe pas përfundimit të hetimit, ai nuk ka pasur mjete efektive për ndalimin e konfiskimit. Disa herë ai u është drejtuar autoriteteve gjyqësore duke kërkuar kthimin e sendeve të konfiskuara; mirëpo, asnjëherë nuk është marrë vendim formal për bazueshmërinë e kërkesës së tij.

107. Ankuesi gjithashtu thekson se nuk i është lejuar paraqitja e kërkesës për kompensim për shkak të imunitetit që e kishin autoritetet e UNMIK-ut me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/47 të datës 18 gusht 2000 për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë.

108. PSSP-ja nuk komenton për bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës. Mirëpo, Paneli përkujton se PSSP-ja ka kundërshtuar pranueshmërinë e ankesës, bazuar në mosshterimin e mjeteve në dispozicion (shih § 55 lart).

2. Vlerësimi i Panelit

109. Në nenin 13 të KEDNJ thuhet:

> "Çdokush të drejtat dhe liritë e të cilit ashtu siç janë paraqitur në këtë Konventë shkelen, ka mundësi të shfrytëzojë mjetet juridike në dispozicion pranë autoriteteve nacionale, pavarësisht nëse shkelja është bërë nga një person i cili vepron në cilësi të një zyrtari."

110. Ashtu siç konstaton Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, "neni 13 i Konventës garanton dispozicionin e një mjeti juridik në nivel nacional për të zbatuar thelbin e të drejtave dhe lirive të Konventës në cilëndo formë që ata mund të sigurohen. Efekti i kësaj dispozite është pra të kërkojë sigurimin e një mjeti vendor për të trajtuar thelbin e një 'ankese të kundërshtueshme' sipas Konventës, dhe të ofrojë ndihmën e duhur" (GJEDNJ (Grand Chamber), *Hirsi Jamaa dhe të tjerët kundër Italisë*, nr. 27765/09, aktgjykim i 23 shkurtit 2012, § 197).

111. Paneli tashmë ka konstatuar se mbajtja e masave për konfiskim në fuqi për më shumë se tri vite pas fillimit të periudhës për të cilën Paneli ka juridiksion, dhe moskthimi i mallrave të konfiskuara pas përfundimit të procedurës penale rezultoi me shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ (shih §§ 98 dhe 103 lart). Prandaj , ankuesi duhet të konsiderohet se ka ankesë të "kundërshtueshme" për qëllimet e nenit 13.

112. Nuk duket se Ligji i Procedurës Penale (LPP) i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë i ka siguruar ankuesit mjet efektiv për të ndërprerë masat për konfiskim përderisa procedura penale ishte në pritje. PSSP-aj nuk u referohet mjeteve të tilla. Sa i përket Panelit ai thekson se neni 151 (4) i LPP parasheh që personi, ndaj të cilit janë ndërmarrë veprime të caktuara hetimore, siç është konfiskimi i mallrave gjatë një bastisjeje, "ka të drejtë të parashtrojë ankesë pranë prokurorit kompetent brenda një periudhe prej tri ditësh". Ky mekanizëm i ankesës me sa duket nuk është mjet në dispozicion për personin i cili ankohet për vazhdimin e konfiskimit të mallrave të tij. Neni 181 i LPP parasheh që gjatë hetimit "palët dhe palët e dëmtuara gjithmonë mund të paraqesin ankesë tek kryetari i gjykatës pranë së cilës po zbatohet procedura, për shkak të prolongimit të procedurës apo parregullsive të tjera gjatë hetimeve" (§ 1). Mirëpo, edhe nëse supozojmë se ankuesi do ta shfrytëzonte këtë mundësi, gjëja e vetme që ai ka mundur të presë ka qenë që "kryetari i gjykatës të hetonte pohimet në ankesë" dhe ta informonte atë se cili veprim është ndërmarrë" (§ 2). Paneli nuk konsideron se mjeti i tillë ofron garancione të mjaftueshme për t'u kualifikuar si "mjet i efektshëm". Mjete të tjera që mund të merren parasysh Paneli nuk sheh.

113. Gjithashtu, sa i përket kërkesës për kompensim për dëmin e shkaktuar me faktin se mallrat e konfiskuara nuk iu kthyen ankuesit, Paneli thekson se PSSP-ja, i cili kundërshtoi pranueshmërinë e ankesës, argumentoi se ankuesi mund t'i qaset komunës së Gjilanit dhe/ose KFOR-it, "përmes procedurave të tyre administrative", për të marrë kompensimin (shih § 55 lart). Mirëpo, Paneli ka konstatuar se PSSP-ja nuk e ka cekur bazën ligjore për asnjërën nga këto kërkesa, dhe nuk ka mundur të gjegjë asnjë bazë ligjore (shih § 59 lart). Nuk sheh mekanizëm tjetër që ankuesit do t'i lejonte të kërkojë kompensim për akte të padrejta që pohohet se janë kryer nga autoritetet gjyqësore.

114. Prandaj, Paneli konkludon se ka pasur shkelje të nenit 13 të KEDNJ lidhur me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

3. Pohimi për shkelje të së drejtës për të mos u diskriminuar (neni 14 i KEDNJ)

a) Parashtresa e palëve

115. Ankuesi më në fund argumenton se, derisa diskriminimi në Kosovë është i ndaluar me Ligjin kundër diskriminimit, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 shkurt 2004 (Ligji nr. 2004/3) dhe të shpallur nga PSSP-ja më 20 gusht 2004 (Rregullorja nr. 2004/32), ai dhe familja e tij ishin objekt i drejtpërdrejtë i diskriminimit të bërë nga UNMIK-u.

116. PSSP-ja nuk komenton për bazueshmërinë e kësaj pjese të ankesës.

b) Vlerësimi i Panelit

117. Në pjesët relevante të nenit 14 të KEDNJ thuhet si vijon:

> "Gëzimi i të drejtave dhe lirive të paraqitura në këtë Konventë sigurohet pa diskriminim në asnjë bazë siç është gjinia, raca, ngjyra, gjuha, religjioni … prejardhja nacionale apo shoqërore…"

118. Paneli konsideron se ankuesi nuk tregon se mbi cilën bazë ai pohon se ka qenë objekt i diskriminimit. Ai nuk tregon ndonjë kategori të personave me të cilët e bën krahasimin se i është nënshtruar një trajtimi ndryshe nga ata.

119. Paneli konkludon se nuk ka dëshmi për ndonjë diskriminim. Prandaj, duhet të konkludojë se nuk ka pasur shkelje të nenit 14 të KEDNJ.

V. REKOMANDIMET

120. Duke marrë parasysh të gjeturat e Panelit në këtë rast, Paneli mendon se ndonjë lloj forme e reparacionit është i nevojshëm.

121. Ankuesi kërkon kompensim për dëme monetare, thënë më saktë për humbjen e fitimeve për shkak të pamundësisë së shitjes së municionit të konfiskuar, që llogaritet të jetë 297,500 euro (duke përfshirë edhe interesin e llogaritur deri në shtator 2009), dhe për dëme jomonetare, që llogaritet të jenë 100,000 euro.

122. Paneli konsideron se nuk është realiste të pritet që mallrat e konfiskuara t'i kthehen ndonjëherë ankuesit. Në këto rrethana, Paneli mendon se UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapat e duhur për t'i siguruar kompensimin adekuat ankuesit për dëmet monetare dhe jomonetare.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

1. HUDH POSHTË KUNDËRSHTIMIN PËR PRANUESHMËRINË E ANKESËS DHE ANKESËN E SHPALL TË PRANUESHME;

2. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SHKAK TË MUNGESËS SË QASJES NË GJYKATË;

3. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT PËR SHKAK TË KOHËZGJATJES SË PROCEDURËS;

4. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

5. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 13 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

6. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 14 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT;

7. REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. TË NDËRMERR HAPAT E DUHURA PËR KOMPENSIMIN ADEKUAT TË ANKUESIT PËR DËMET MONETARE DHE JOMONETARE;

b. TË NDËRMERR MASA TË MENJËHERËSHME DHE EFEKTIVE PËR IMPLEMENTIMIN E REKOMANDIMEVE TË PANELIT DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN PËR ZHVILLIMET E MËTEJSHME NË KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar